



PROCESVERBAL VIII/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VIII (tetë) për vitin 2023 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 20.09.2023
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

z. Urim Suka

znj. Bulëza Kuçi

znj. Fidaije Kukaj

znj. Sanie Kuçi Rexhepaj

z. Dardan Berisha

z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore

Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2024;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani” me seli në Suharekë;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 i datës 29.01.2021;**
- 6. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e ZKA-së;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Liridon Fandaj - propozoj që pika pyetje dhe përgjigje të jetë si pikë e tretë në rend dite për Asamble për arsye se s’ka kuorum gjatë asaj pike dhe ne po e mbajmë ashtu.

Avni Bytyqi - pavarësisht cilën do pikë të rendit që e fusim,ne nuk mund ti obligojmë anëtarët e Kuvendit me qëndru aty. Për momentin ata e kanë të drejtën të dalin jashtë dhe mos të dëgjojnë dhe kur vje pika që e kanë proces të votimit,të vijnë dhe të futen në mbledhje. Ata që shprehin interesim të dëgjojnë dhe të bëjnë pyetje,qëndrojnë.

Kryesuesi - ne në fund e diskutojmë dhe e hedhim në votim se në cilën pikë ta lëmë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - mos diskutuat për pikën time të rendit të ditës?

Kryesuesi - nuk kam marrë asgjë me shkrim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - unë e kam dorëzuar kërkesën time me shkrim dhe nëse ka mundësi me pas mirëkuptim nga anëtarët tjerë dhe me u inkuadru në kuadër të kësaj seance.

Urim Suka - ne e miratuam rendin e ditës.

Kryesuesi - Sania është në komision për ndarjen e banesave në mes Komunës dhe investitorëve te Agi. Sania ka dhënë dorëheqje nga ai komision dhe më ka informuar me shkrim por unë kam kërkuar që kërkesën ta bëjë në mënyrë zyrtare,të protokoluar por që mua nuk më ka ardhë ende.

Avni Bytyqi - nuk është çështje e jotja a e zëvendëson apo jo ekzekutivi. Faktikisht ti ke dhënë dorëheqje dhe e ke krye obligimin tënd.

Sanie Kuçi Rexhepaj - kërkesën e kam dorëzuar me 3 gusht dhe shkresat me email janë zyrtare por keni kërkuar në minutën e fundit me protokoll dhe e kam përfundu edhe atë pjesë. Unë kam dhënë dorëheqje nga ai komision me arsyetimin tim por më vje keq me shkaktuar vonesa dhe a zëvendësohet apo jo nuk është punë e imja.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2024;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - shqetësimet e njëjta që i kemi ngrit më herët, ne po duhet sot me fol dhe nuk i kemi njerëzit të cilët duhet me na u përgjigj, ata që janë kompetent. Unë iu kam përgjigj ftesës së OSBE-së lidhur me dëgjimet publike për listën e investimeve kapitale dhe kam ardhë me dhënë kontributin tim që ai dokument me qenë sa më i mirë. Aty i kam dhënë vërejtjet konkrete për secilin projekt. Kur tash e analizoj komplet atë që kemi fol atë ditë dhe çka na ka ardhë sot, 99 % është i njëjti dokument. 1 % është përfill te shkolla e Maqitevës ku janë heq 110.000€. Për mua është e papranueshme dhe nuk duhet të kaloj.

Sanie Kuçi Rexhepaj - çështja është që kur mbërrijnë ata në fund të takimeve, ne neglizhohemi nga ekzekutivi dhe është njëra prej arsyeve që nuk kam ardhë. Kur mbahen takimet, ne flasim në ajër dhe askush s'po na dëgjon dhe nuk po na kundër përgjigjet. Takimi i organizuar nga OSBE që është mbajtur, u mbajtë sa për sy e faqe, sa me kry një obligim ligjor që i takon KPF-së. Edhe në KPF njëjtë dhe unë nuk e di a ka qenë ndonjëherë në këtë mandat në takime të KPF-së Kryetari. Edhe drejtorët që i kanë pikat e rendit të ditës nuk vijnë përveq Drejtorit të Pronës. Asambleja është duke u injorur këtë mandat komplet.

Liridon Fandaj - dy vjet po i bën në këtë mandat Kryetari dhe vetëm dy herë ka qenë në KPF e ndoshta është njëri prej misionëve më të rëndësishme ku merren shumë vendime. Te pjesa e investimeve kapitale, pasi Drejtori i Shërbimeve Publike nuk është, mendoj që Drejtori i Financave mund të na jap përgjigje se në çfarë baze janë formu këto ndarje buxhetore të investimeve kapitale. Në cilin prej fshatrave dhe brenda në qytet janë marrë shqetësimet ose kërkesat e qytetarëve? Nëse e dëshmon që janë kërkesa të qytetarëve dhe janë në bazë të procesverbaleve atëherë unë mund të pajtohem. Për Shtëpinë e Kulturës në Mushtisht janë nda 250.000€ për vitin 2023 dhe po e shoh që edhe në vitin 2024 është një shumë prej 200.000€. Për pjesën te shkolla e Maqitevës, vitin e kaluar kanë qenë 120.000€ dhe tani janë 200.000€. Ka edhe shumë të tjera dhe vota jonë për këtë projekt buxhet është kundër.

Kryesuesi - sa i përket Kryetarit, mungesa e tij është çështje e tij. Shpeshherë e zëvendëson edhe nënkryetarja por ajo është sot është në Prishtinë.

Urim Suka - dokumenti është tepër jo serioz dhe ju lus mos ta votoni.

Kryesuesi - dokumenti është serioz.

Urim Suka - Pse e kemi mbajtur takimin nën organizimin e OSBE-së? Kur mendimet tona janë të bazu ne, a është dasht të përfillen? E njëjta po ndodh me dëgjimet publike. Ju po i ftoni qytetarët dhe këtu askund nuk pasqyrohen kërkesat e qytetarëve.

Liridon Fandaj - kërkoj përgjigjen nga Drejtori i financave se në çfarë baze është nda ky buxhet?

Labinot Halitjaha - ne si drejtori kemi vazhdu me takime sipas ligjit nëpër fshatrat e Komunës së Suharekës. Buxheti është nda sipas numrit të banorëve nëpër fshatra. Kërkesat që janë fut në buxhet, shumica janë kërkesa të takimeve nëpër fshatra dhe në bazë të shënimeve që Kryetarët e këshillave të fshatrave i kanë sjell. E kemi bërë bashkë dyjëzimin e kërkesave dhe i kemi fut në buxhet. Investimet më të mëdha kapitale ekzekutivi e ka pas të arsyeshme ti bëjë në bazë të kërkesave të qytetarëve dhe analizës së ekzekutivit.

Liridon Fandaj - a ka fillu shtëpia e kulturës në Mushtisht?

Labinot Halitjaha - shtëpia e kulturës në Mushtisht nuk ka fillu. Jemi duke prit një procedurë ku është në pyetje që objekti është duke kalu në fazën se a do të futet në trashëgimi kulturore për vitin 2022-2023 dhe ne jemi duke prit përgjigje nga ministri Qeku ku na ka dhënë përgjigje verbale që do të fillojë Shtëpia e Kulturës në Mushtisht mirëpo vendim me shkrim nuk kemi akoma.

Liridon Fandaj - deri në 2023-tën është një vendim. Nëse ne i kemi planifiku 250.000 në 2023-tën dhe jemi në muajin e dhjetë dhe nuk ka fillim të punimeve, cila është logjika me i planifiku edhe 200.000€ në vitin 2024? Ose duhet me pas një lokacion të ri dhe jo të njëjtin lokacion. Nëse mbesin 250.000€ të këtij viti pa shfrytëzua, ku shkojnë 250.000€?

Labinot Halitjaha - ne jemi duke e prit vendimin e ministrit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

3 për,3 kundër,1 apstenim

Kryesuesi përdor të drejtën e votës së dyfishtë dhe voton pro.

Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani” me seli në Suharekë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ky vendim është miratua seancën e kaluar, është kthyer dhe unë nuk kam asnjë informatë se pse është kthyer. Ne kemi kërkuar vazhdimisht që nëse kthehet një vendim, ne me pas materialin se pse po na kthehet ai vendim. Unë tash e kuptova se pse është kthyer ky vendim dhe është mirë shkresën e ministrisë me na ofruar neve prej fillimit. Për deri sa ne një vendim të tillë e kemi marrë, ky vendim a duhet me qenë plotësim-ndryshim apo duhet me qenë vendim i ri? Nëse është vendim i ri, çka ndodh me vendimin që e kemi marrë atëherë? Kërkoj sqarime nga zyrtari ligjor.

Avni Bytyqi - vendimet të cilat dërgohen në Ministri dhe kthehen në rishqyrtim, ato vendime nuk krijojnë efekt juridik dhe nuk janë të ekzekutueshme dhe nuk janë të zbatueshme. Për këtë arsye asnjëherë nuk kam hy me këto elemente që vendimin ta bëjmë plotësim-ndryshim për deri sa nuk ka prodhuar efekt juridik. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Urim Suka - ne kemi qenë kundër atëherë dhe jemi kundër edhe tash.

Dardan Berisha - ndryshim-vendimet a kanë ndonjë limit?.

Avni Bytyqi - nuk ka ndonjë akt ligjor që e rregullon apo e ndalon. Është në diskrecionin e Kryetarit dhe të Kuvendit me vazhdu më tutje.

Liridon Fandaj - ky vendim është i kundërligjshëm. Ky është etnitet ose subjekt privat i cili nuk ka të drejtë as me konkuru. Ky kod është i Drejtorisë së Kulturës dhe nuk ka të drejtë me u subvencionu prej Drejtorisë së Kulturës. Në kuadër të këtij vendimi është dasht me na i bashkëngjitur edhe kodin buxhetor se prej cilave mjete i kalojmë këto mjete ose duhet të bëj një shkresë vet si asamblistë në Ministrinë e Financave dhe me kërkua një interpretim, se ky nuk është etnitet publik por është privat. A lejohet nga ky kod buxhetor?

Kryesuesi - ata e vërtetojnë a lejohet apo nuk lejohet nga ky kod.

Dardan Berisha - 160.000€ me cilin kod kanë shku?

Kryesuesi - me vendim të Asamblesë por nuk kanë kërku kod atëherë.

Avni Bytyqi - dy vendimet e mëparshme që i ka miratuar Kuvendi, për të dyja e ka konfirmim ligjshmërinë Ministria e Financave. Në vendimin e parë nuk e kanë diskutu këtë çështje dhe e kanë kthyer përnjëherë që është konform legjisllacionit në fuqi dhe mund të ekzekutohet. Vendimi e vitit 2022 është analizu në dy çështje: çështja financiare e buxhetit dhe çështja e trajtimit të statusit të klubit “Ballkani” ku thotë: Në çështjen e mjeteve financiare Ministria e Financave ka konstatuar se Komuna ka buxhet të mjaftueshëm për ta subvencion klubin e Ballkanit në të njëjtën kategori, në të njëjtën drejtori, në të njëjtin buxhet por e ka të paqartë që klubi i Ballkanit a e ka statusin e personit juridik apo statusin e OJQ-së. Nëse e konstatojnë që klubi i Ballkanit e ka statusin e personit juridik, personit privat atëherë konstatojmë se vendimi i Asamblesë është i ligjshëm dhe mund të ekzekutohet. Nëse e ka statusin e OJQ-së atëherë duhet të nënshtrohet procedurave të thirrjes publike sipas rregullores për subvencionimin e OJQ-ve. Ne në këtë rast kemi vepru sipas rekomandimit që e ka dhënë Ministria e Financave.

Liridon Fandaj - prej cilit kod janë ato dy vendime?

Avni Bytyqi - prej kategorisë së subvencioneve të Drejtorisë së Kulturës, pa e cek programin.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

3 për, 3 kundër, 1 apstenim

Kryesuesi e përdor të drejtën e votës së dyfishtë dhe voton për.

Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe fjalën ia jep zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - Drejtoria e Arsimit ka mbajtur takim dhe është zgjedhur kryetari i ri i këshillit të prindërve sipas udhëzimit administrativ dhe ajo është Herolinda Berisha. Në bazë të udhëzimit administrativ për themelimin e KKSB-së, kryetari i këshillit të prindërve, me automatizëm shkon në KKSB dhe ne e kemi obligim me e bë plotësim-ndryshimin e atij anëtar.

Liridon Fandaj - a keni procesverbal se si u zgjedh ajo?

Avni Bytyqi - besoj që e kanë DKA.

Liridon Fandaj - ka mungesë të dokumenteve dhe po na vje vetëm emri. Nuk po e dimë kush është.

Avni Bytyqi - shqetësimin tuaj do t'ja përcjellim DKA-së dhe do të kërkojmë që ta sjellin procesverbalin në mbledhjen e Asamblesë.

Urim Suka - shumë po na krijon konfuzion kjo situatë dhe është e thjeshtë në vetvete. Nuk e kemi vetëm për opozitë por e kemi për funksionim. Bashkë me këtë material bashkëngjiti edhe materialet përcjellëse që duhet sepse është jo serioze.

Bulëza Kuçi - për me u zgjedhur Herolinda është dashtë secila shkollë me pas përfaqësuesin e vet të prindërve. Unë jam mësimdhënëse dhe prej shkollës tonë unë nuk e di që ka qenë dikush dhe që e keni ftuar. Ndoshta edhe jam e pa informuar.

Avni Bytyqi - kur drejtori ka kërkuar me inicuar këtë procedurë, unë kam kërkuar shkresë zyrtare nga drejtori dhe procesverbalin por kërkesa është mangët.

Dardan Berisha - ne si anëtar të KPF-së mund ti japim një rekomandim Drejtorit të DKA-së që të na sjell shkresën në seancë dhe jo vetëm për këtë rast por edhe për shumë raste tjera.

Urim Suka - për deri sa ka ardhë kjo letër, a i ka respektua të gjitha procedurat ligjore për me ardhë te ne? Nëse nuk është respektu, kthejeni në fillim dhe ndiqeni procedurën.

Kryesuesi - faktikisht si kërkesë ka shku nga DKA-ja.

Avni Bytyqi - një shkresë që vjen prej drejtorisë, unë e vlerësoj që është kërkesë e besueshme dhe unë duhet ta zbatoj atë kërkesë. Ai e mban përgjegjësinë nëse nuk i ka respektuar procedurat e zgjedhjes të atij kryetari të këshillit të prindërve.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

**4 për, 3 kundër
Miratohet pika 4**

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 i datës 29.01.2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Avni Bytyqi - bëhet fjalë për pronat që i kemi dhënë në Biraq, që Kuvendi i ka miratu të ia jap si përfitues "Cima grup" shpk për ndërtimin e stadiumit. Neni 3 paragrafi 2 nga ana e komisionit është kërkuar që pasi të shpallet fitues, në afat prej dhjetë ditësh ta sjell garancionin bankar. Mirëpo garancionin bankar nuk e ka sjell në atë kohë dhe tash Kryetari ka kërku që këtë vendim duhet ta shfuqizojmë për arsye se nuk është plotësuar kriteri. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - nuk mundemi me u arsyetuar në sot dhe me thanë që nuk e ka zbatu ky nenin 3, e dy vjet e kemi lënë atë pronë. Nëse ai nuk ka ardhë me nënshkrua kontratën, është dashtë me ndërpre, përndryshe ai është i obliguar me pagu atë 10 %. Dikush e ka dëmtu Komunën, ose Kryetari, ose biznesi. Në bazë të asaj që po flitet e ka dëmtuar Kryetari.

Urim Suka - një javë përpara ishte një deklaratë e ministrit, ku i thua që kemi nda buxhet për ta ndërtuar studionin e qytetit në Suharekë dhe pas një jave parcela qenka e ndamë. Po vje vendimi me ia hek atë parcelë, nëse po e kuptoj.

Avni Bytyqi - iu është dhënë në shfrytëzim për me ndërtuar Cima stadiumin.

Urim Suka - a mundemi këtë vendim sa ma shpejtë me bë dhe me ia dërgu ministrisë dhe le të vje ai le të investon sepse ka thënë që i kam nda paret.

Avni Bytyqi - është referu që kjo çështje të jetë për stadium të qytetit mirëpo kur është hartu Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e Komunës, është defekt i Drejtorisë së Kulturës apo e Komunës që nuk e ka planifikuar në kuadër të PZHK-së dhe HZK-së ndërtimin e stadiumit në atë parcelë.

Liridon Fandaj - e kujt është kjo përgjegjësi, a është e Kryetarit apo e komisionit?

Avni Bytyqi - "Cima Group" nuk e ka sjellë garancionin bankar dhe si pasojë që nuk e ka sjellë, nuk mundemi ne me ia konfisku sepse nuk është shfuqizua.

Liridon Fandaj - a ka mundësi me pas një dokument që vërteton që nuk e ka nënshkruar kontratën?

Avni Bytyqi - po. E kam kërkesën kur iu kam drejtuar në emër të Kryetarit të Komunës që ai ta sjell garancionin bankar në afat prej dhjetë ditësh nga dita e miratimit të vendimit por ai nuk e ka sjell.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

**4 për, 3 kundër
Miratohet pika 5**

Pika 6. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e ZKA-së;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin për pikën 6.

Urim Suka - Plani le të shkon sepse është obligim i Komunës me pas një plan. Por problemi është te vullneti politikë që ju nuk e keni për me i përmbush këto plane. Te lista e investimeve kapitale, ju kamë thënë ku janë gabimet dhe ju asnjërën nuk e keni përmirësuar. Ju nuk keni vullnet me i ndal këto keqpërdorime. Uroj që ju ta shihni këtë situatë dhe të reflektoni si pushtet dhe si Komunë dhe ti merrni për bazë edhe fjalët tona që kemi thënë më herët dhe rekomandimet e auditorëve dhe ta ndryshoni gjendjen sepse gjendja është për keqardhje dhe nuk do. Kjo po shihet edhe me vendime, me aktakuza. Ky buxhet kur miratohet në këtë formë, ka me prodhu shkelje ligjore të njëpasnjëshme.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

**6 për, 1 apstenim
Miratohet pika 6**

Takimi përfundoi: 14:05

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj